

UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN

FAKULTETI: SHKENCA KOMPJUTERIKE

PROGRAMI I STUDIMEVE MASTER: E – QEVERISJE



PUNIM DIPLOME

**DIXITALIZIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE NË KOMUNËN E VITISË,
GJILAN DHE KAMENICËS**

(RAST STUDIMI SEKTORI I KADASTRIT)

Mentor:

Prof.Dr. Sadik HAXHIU

Kandidatja:

Shkurte SADIKU

Gjilan, 2026

UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN

FAKULTETI: SHKENCA KOMPJUTERIKE

PROGRAMI: E – QEVERISJE



PUNIM DIPLOME

Fakulteti: **Shkenca Kompjuterike**

Titulli punimit: ***”Dixhitalizimi i shërbimeve publike në komunën e Vitisë, Gjiat dhe Kamenicës - rast studimi sektori i Kadastrit ”***

Emri dhe Mbiemri: **Shkurte Sadiku**

Numri i amzës (ID Regjistrimi): **22181019**

Departamenti: **Fakulteti Shkencave Kompjuterike**

Niveli Studimeve: **Master**

Programi i studimit: **E-Qeverisja**

Mentor i punimit: **Prof.Dr.Sadiku Haxhiu**

Gjiat, 2026



Universiteti Publik - “KADRI ZEKA” - Public University

rr. “Zija Shemsiu” pn.

60000 Gjiilan tel:

+381280390112

e-mail: info@uni-gjiilan.net

Programi i Studimeve Master

DEKLARATA ETIKE

Unë, **Shkurtë Sadiku**, në kuadër të punimit me temë “*Dixhitalizimi i shërbimeve publike në komunën e Vitisë, Gjiilan dhe Kamenicës – rast studimi sektori i Kadastrit*”, deklaroj se të gjitha të dhënat dhe informacionet e përdorura në këtë punim janë mbledhur dhe trajtuar me korrektësi dhe përgjegjësi, në përputhje me standardet akademike dhe etike të kërkimit shkencor. Të dhënat janë siguruar nga burime të besueshme dhe janë përdorur vetëm për qëllime studimore. Gjithashtu, angazhohem që të gjitha burimet e përdorura janë cituar në mënyrë të rregullt, duke respektuar parimet e objektivitetit dhe duke shmangur çdo formë të plagjiaturës.

Në Gjiilan, 30/06/2026

MIRËNJOHJE DHE FALËNDERIME

Shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim të sinqertë për të gjithë ata që më kanë mbështetur dhe ndihmuar gjatë realizimit të këtij punimi. Falënderoj profesorët dhe stafin akademik për përkrahjen, këshillat dhe njohuritë e ofruara gjatë studimeve.

Një falënderim i veçantë shkon për bashkëshortin tim për mbështetjen, mirëkuptimin dhe përkrahjen e vazhdueshme gjatë gjithë këtij rrugëtimi akademik. Po ashtu, falënderoj edhe fëmijët e mi për durimin dhe motivimin që më kanë dhënë, duke qenë burim i vazhdueshëm force dhe frymëzimi. Gjithashtu, shpreh mirënjohjen time të thellë për të gjithë personat dhe institucionet që kontribuan me informacion dhe bashkëpunim gjatë procesit të hulumtimit, duke mundësuar realizimin e këtij studimi.

ABSTRAKT

Duke marrë parasysh zhvillimin e teknologjisë, e cila ka ndikuar në zhvillimin e shpejtë të jetës dhe në ndryshimin e mënyrës së jetesës, ajo ka ndikuar pothuajse në të gjitha fushat duke e lehtësuar dhe thjeshtësuar shumë punë, te sektorit Kadastrare ne komune tonë si dhe më e rëndësishmja është se përmes Digjitalizimi i shërbimeve publike në komunën e Vitisë në sektori e Kadastrit ne mund të kursejmë shumë më shumë kohë. Zhvillimi i internetit ka ndikuar edhe në zhvillimin dhe avancimin e institucioneve të ndryshme, si dhe së fundmi ka ndikuar edhe në sektorin e Kadastrit. Ky studim është mjaftë i rëndësishëm për t'i parë zhvillimet ndër vite të Katastrit, se si atë e kanë lehtësuar puntoret e këtij sherbimit si dhe qytetaret në gjetjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme si dhe deri te organizimi i punëve administrative. Hipoteza e përgjithshme e këtij punimi do të jetë ndikimi i teknologjisë dhe transformimit të Kadastrit tradicionale në kadastrin moderne, si kanë qenë pritshmëritë e qytetarve dhe të stafit administrativ. Punimi i këtij studimi do të bazohet në hulumtimin e literaturës nga autorë të ndryshëm, mbledhja dhe analiza e të dhënave rreth Kadestarit.

Po ashtu do të analizojë në mënyrë kritike vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga autor të cilësuar në këtë lëmi, si dhe literatura dhe raporte relevante, artikuj të ndryshëm studimor dhe të dhëna të tjera. Në mënyrë të veçantë do të analizojmë raportet e stafin e Kadastarit dhe Kadestarisnë së përgjithësi, si është interesimi i tyre. Informatat e nxjerra nga këto analiza dhe krahasime do të shërbejnë për evidentimin e devijimeve të caktuara. Sa i përket pjesës praktike studimore mënyra apo qasja e përfitimit të të dhënave do të bëj përmes metodave të njohura siç janë: metodat hulumtuese apo e vështirimit dhe metoda deskriptive, ndërsa hipotezat do ti testojme me paython. Gjithashtu për të nxjerrë informacione dhe statistika sa më të sakta do të intervistoj persona të ndryshëm të personelit të administrativ apo edhe vet qytetere që marrin sherbimet ne këtë sektor publik.

Fjalët kyçe: administrimi, dixhitalizimi, komuna, sektori i kadastrit etj.,

ABSTRACT

Considering the development of technology, which has significantly influenced the rapid progress of life and changes in the way people live, it has affected almost all fields by facilitating and simplifying many processes, including the cadastral sector in our municipality. One of the most important aspects is that through the digitalization of public services in the Municipality of Viti, particularly in the cadastral sector, a considerable amount of time can be saved.

The development of the internet has also contributed to the advancement of various institutions and, more recently, has had a significant impact on the cadastral sector. This study is important in order to observe the developments of the cadastre over the years, how these developments have facilitated the work of employees in this service, and how they have helped citizens in accessing necessary data and information, as well as in the organization of administrative tasks.

The general hypothesis of this study focuses on the impact of technology and the transformation of the traditional cadastre into a modern cadastral system, as well as the expectations of citizens and administrative staff regarding these changes. This research will be based on a review of literature from various authors, as well as the collection and analysis of data related to the cadastral sector.

Furthermore, it will critically analyze the observations and suggestions provided by recognized authors in this field, along with relevant literature, reports, academic articles, and other available data. Special attention will be given to the analysis of reports and the perspectives of cadastral staff regarding the functioning and development of the cadastre in general. The information obtained from these analyses and comparisons will serve to identify possible deviations or challenges. Regarding the practical research part, the data collection will be conducted through well-known research methods such as observational methods and descriptive methods. In addition, to obtain accurate information and statistics, interviews will be conducted with different administrative staff members as well as with citizens who receive services from this public sector.

Keywords: Administration, Digitalization, Municipality, Cadastral Sector

Përmbajtja

ABSTRAKT	5
KAPITULLI I.....	11
1. HYRJA.....	11
1.1 Përkufizimi dhe arsyetimi i temës së propozuar	13
1.2 Qëllimi i studimit dhe objektivat.....	14
1.3 Gjendja aktuale e studimeve për problemin e hulumtuar (baza teorike).....	15
1.4 Hipotezat, pyetjet kërkimore dhe formulimi i problemeve të hulumtimit.....	16
1.5 Metodologjia dhe metodat e hulumtimit	17
1.6 Rezultatet e pritura të hulumtimit.....	18
KAPITULLI II	19
RISHIKIMI I LITERATURËS	19
2. Koncepti i dixhitalizimit	19
2.1 Dixhitalizimi i shërbimeve publike	21
2.2.1 Transformimi digjital në institucionet publike.....	22
2.2.2 Përfitimet e dixhitalizimit për qytetarët	23
2.2.3 Sfida në implementimin e shërbimeve digjitale	25
2.3 Roli i teknologjisë në administratën publike.....	26
2.4 Zhvillimi i sistemit të kadastrit.....	27
2.5 Kadastri digjital dhe sistemet informative.....	29
2.6 Historia dhe zhvillimi i kadastrit	31
2.6.1 Sistemi tradicional i kadastrit.....	33
2.6.2 Kalimi nga kadastri tradicional në atë modern.....	34
2.7 Sistemet digjitale për menaxhimin e të dhënave kadastrale.....	35
2.7.1 Rëndësia e sistemeve informative në kadastrë	36

2.7.2 Përfitimet e kadastrit digjital për qytetarët dhe administratën.....	37
KAPITULLI III	38
3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	38
3.1 Metodat e hulumtimit	38
3.2 Instrumentet e hulumtimit	39
3.3 Populacioni dhe mostra	40
3.4 Procedurat e mbledhjes dhe analizës së të dhënave	41
KAPITULLI IV	42
4. PREZENTIMI, ANALIZIMI DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE	42
4.1 Prezentimi dhe analizimi i rezultateve	42
4.2 Argumentimi i pyetjeve kërkimore	52
4.3 Testimi i hipotezave	57
5. PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET	61
5.2 Rekomandimet	63
5.2 Referencat.....	64

TABELA E GRAFIKONEVE

Grafiku 1. Gjinia	43
Grafiku 2. Mosha	43
Grafiku 3. Niveli arsimor	44
Grafiku 4. A mendoni se digjitalizimi ka reduktuar kohen e pritjes?	44
Grafiku 5. Sa i kenaqur jeni me sherbimet digjitale?	45
Grafiku 6. Sa shpesh perdorni sherbimet online?	45
Grafiku 7. A mendoni se informimi është më i shpejtë dhe më i sigurt?	46
Grafiku 8. Sa ka ndikuar teknologjia ne sherbimet kadastrale?	46
Grafiku 9. A kane qytetaret rol aktiv?	47
Grafiku 10. Sa e lehte eshte perdorimi i platformes?	47
Grafiku 11. A jeni te informuar per regjistrimin e pronave?	48
Grafiku 12. A perdoren sisteme te avancuara?	49
Grafiku 13. Cilat jane sfidat kryesore?	49
Grafiku 14. A ka nevojë për trajnime stafi?	50
Pytja 15. A mendoni se mungesa e digjitalizimit dhe dokumentacionit në sistemin kadastral ka ndikuar në problemet e komasacionit të tokave bujqësore në Komunën e Vitisë, duke vështirësuar blerjen dhe shitjen e tyre?	51

SHKURTESAT

***TIK** – Teknologjia Informative Komunikimit*

***AKK** - Agjencia Kadastrale e Kosovës*

***DT** - Digital Transformation*

***SI** - Siguria*

***PR** – Privatësia*

***GIS**- Geographic Information System*

KAPITULLI I

1. HYRJA

Në këtë punim do të analizohet dhe studiohet gjendja aktuale e sektorit të Kadastrit, si dhe niveli i përfshirjes së teknologjisë në funksionimin e tij, me qëllim të avancimit dhe lehtësimit të proceseve të punës për punonjësit dhe qytetarët. Zhvillimi i teknologjisë informative ka krijuar mundësi të reja për modernizimin e institucioneve publike, duke përfshirë edhe sektorin e kadastrit, i cili luan një rol shumë të rëndësishëm në administrimin dhe menaxhimin e pronës. Dixhitalizimi i shërbimeve publike në këtë sektor paraqet një hap të rëndësishëm drejt rritjes së efikasitetit, transparencës dhe qasjes më të lehtë në informacion për qytetarët. Përmes përdorimit të sistemeve digjitale, qytetarët mund të kenë qasje më të shpejtë dhe më të thjeshtë në të dhënat e nevojshme, ndërsa administrata mund të menaxhojë më mirë dokumentacionin dhe proceset administrative. Ky projekt konsiderohet shumë i nevojshëm për komunat tona, pasi ndihmon në thjeshtimin e procedurave administrative, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe përmirësimin e komunikimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve.

Sistemi i dixhitalizuar do të përdoret nga disa kategori të rëndësishme të përfituesve, duke përfshirë stafin e kadastrit (drejtorin dhe administratën), si dhe qytetarët e zakonshëm, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, duke ofruar mundësi më të barabarta për qasje në shërbime. Arsyeja kryesore e zgjedhjes së kësaj teme lidhet me rëndësinë që ka modernizimi i kadastrit dhe përhapja e teknologjisë në këtë sektor. Përmes këtij avancimi mund të kurset kohë, të përmirësohet menaxhimi i kërkesave të qytetarëve dhe të rritet efikasiteti i punës së stafit administrativ në përgjithësi. Gjithashtu, DT ndihmon në reduktimin e procedurave burokratike dhe në rritjen e transparencës së institucioneve publike.

Në këtë rast studimor do të analizohet në mënyrë të detajuar çdo fazë e zhvillimit dhe implementimit të dixhitalizimit në sektorin e kadastrit. Studimi do të fillojë me analizën e gjendjes aktuale të kadastrit në komunat përkatëse, duke identifikuar sfidat dhe problemet ekzistuese.

Më pas do të analizohen metodologjitë e përdorura, si dhe faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që ndikojnë në funksionimin e këtij sektori. Në përfundim të këtij punimi do të paraqiten vlerësimet dhe rezultatet e analizës lidhur me shkallën e dixhitalizimit të shërbimeve publike në sektorin e kadastrit në komunat e Vitisë, Gjilanit dhe Kamenicës. Këto rezultate do të shërbejnë për të kuptuar më mirë nivelin e zhvillimit të këtij sektori dhe për të propozuar rekomandime që mund të kontribuojnë në përmirësimin dhe avancimin e mëtejshëm të shërbimeve kadastrale.

1.1 Përkufizimi dhe arsyetimi i temës së propozuar

Tema e transformimit të kadastrit nga sistemi klasik apo tradicional në një sistem modern lidhet ngushtë me zhvillimin e teknologjisë dhe përdorimin e internetit në administratën publike. Përdorimi i teknologjisë informative ka krijuar mundësi të reja për kryerjen e shumë proceseve administrative në mënyrë më të shpejtë dhe më efikase, duke mundësuar që shumë shërbime të realizohen edhe nga distanca. Kjo qasje ndihmon në kursimin e kohës së qytetarëve dhe të administratës, si dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike.

Realizimi i këtij projekti do të ndihmojë në sigurimin e informacioneve dhe statistikave të ndryshme përmes hulumtimeve dhe analizave të realizuara në sektorin AKK e kadastrit. Përmes këtij studimi synohet të analizohen zhvillimet e kadastrit që nga fazat e hershme të funksionimit të tij, mënyra se si është zhvilluar ndër vite dhe ndryshimet që kanë ndodhur si rezultat i përdorimit të teknologjisë.

Në kuadër të këtij studimi do të trajtohen edhe disa çështje të rëndësishme, si: numri i punonjësve në këtë sektor dhe ndryshimet e mundshme ndër vite, ndikimi i teknologjisë në zhvillimin e shërbimeve kadastrale, si dhe sfidat që mund të kenë hasur punonjësit gjatë procesit të transformimit nga sistemi tradicional në atë modern. Po ashtu do të analizohet nëse teknologjia ka ndikuar në lehtësimin apo vështirësimin e proceseve të punës në kadashtë. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i këtij studimi është analiza e përpjekjeve të sektorit të kadastrit për të avancuar dhe zhvilluar shërbimet e tij, me qëllim të rritjes së interesimit të qytetarëve për përdorimin e këtyre shërbimeve. Gjithashtu do të shqyrtohet se si po zhvillohet aktualisht ky sektor dhe nëse janë duke u përdorur sisteme moderne për menaxhimin dhe administrimin e të dhënave kadastrale.

1.2 Qëllimi i studimit dhe objektivat

Qëllimi i studimit të e-Kadastrit është menaxhimi sa më i mirë, më i lehtë, i shpejtë dhe më efikas për përdoruesit. Ky projekt ka për qëllim gjithashtu t'i njoftoj qytetarët në lidhje me shërbimet, me parcella bujqësore, biznesore si dhe oborre e troje, dhe gjithqka që ka të bëjë me kadastrin. Për këtë arsye lind nevoja për krijimin e një softueri aplikativ për menaxhim. Softveri aplikativ përfshinë programet dhe të dhënat me anë të të cilave zgjidhen problemet e caktuara të shfrytëzuesit. Ato mund të jenë programe apo të dhëna: vetanake, standarde dhe modulare. Programet apo të dhënat vetanake i përpilon shfrytëzuesi individual për nevojat e veta. Gjatë përpilimit të tyre, merren parasyshë kërkesat e vetë shfrytëzuesit, prandaj shumë vështirë përshtaten për nevojat e tjetërkujt. Programet apo të dhënat standarde zhvillohen si gjeneralizim i programeve aplikative të cilat i kanë përpiluar shfrytëzuesit e caktuar. Te këto programe zakonisht nuk ekziston mundësia e ndërrimit të tyre dhe e përshtatjes me kërkesat e reja të shfrytëzuesit. Programet apo të dhënat modulare bashkojnë përparësitë e programeve vetanake dhe të atyre standarde. Këto janë programe të cilat përbëhen prej pjesëve të tyre-moduleve të cilat shfrytëzuesi mund t'i bashkojë sipas nevojave të veta për të fituar programin e dëshiruar. Gjatë realizimit të programeve-preferohet që problemi fillestar për të cilin shkruhet programi të ndahet në nënprobleme. Pas kësaj duhet që për secilin nënproblem të përpilohet nga një program adekuat të cilin shpesh e quajmë nënprogram, e pastaj të shkruajmë programin kryesor, i cili duke i bashkuar të gjitha këto nënprograme mundëson zgjidhjen e problemit të dhënë. Softveri për testime teknike përfshinë programet e dedikuara për testime të caktuara të vetë sistemit kompjuterik. Problemet kyçe të cilat do të trajtohen me këtë rast studimor janë subjektet themelore për zhvillimin dhe implementimin e teknologjisë informative në kadastrë. Kjo përfshin krijimin, implementimin e një projekti i cili do ta menaxhojë kadastrin, përkatësisht dokumente, administratën, qytetarët, inventarin si dhe drejtorët. Disa nga problemet kryesore të cilat i trajton janë: si të bëjmë menaxhmin më të mirë të qytetarëve, si të bëjmë gjetjen e dokumentave në mënyrë më të sigurt dhe efikase, shpërndarja e njoftimeve tek të gjithë, vlerësimi i sjelljes, orarit, dokumenteve të ndryshme, menaxhimi i inventarit, regjistrimi i dokumentave që kërkojnë qytetarët në bazë të kategorisë, në bazë të fshatrave, regjistrimi i pronave dhe pronarve të ri si dhe ata aktual që kanë shtimin e pronave tjera, etj.

1.3 Gjendja aktuale e studimeve për problemin e hulumtuar (baza teorike)

Digjitalizimi i kadastrave ka sjellë një përmirësim të ndjeshëm në transparencën dhe qasjen ndaj informacionit pronësor. Tani, qytetarët kanë mundësinë të aksesojnë lehtësisht të dhënat e nevojshme në çdo kohë dhe nga çdo vend. Kjo ka kontribuar në rritjen e besimit në institucionet publike dhe ka përshpejtuar proceset administrative (Houghton, 2017).

Adoptimi i teknologjive digjitale në sektorin e kadastrit ka sjellë shërbime më efikase, duke reduktuar ndjeshëm kohën për regjistrimin e pronave dhe zvogëluar shpenzimet administrative. Ky përmirësim është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të qyteteve moderne (Norrström, 2019). Digjitalizimi i shërbimeve kadastrale në komunat shqiptare, përfshirë Vitenë, ka hapur mundësi të reja për menaxhimin e pronës dhe ka përmirësuar shërbimet për qytetarët. Kjo ka bërë informacionin më të arritshëm dhe të kuptueshëm për të gjithë (Kamari, 2017).

Duke digjitalizuar sistemet kadastrale, ne jo vetëm që reduktojmë burokracinë, por gjithashtu forcojmë besimin e qytetarëve në qeverisjen publike (Gwalani, 2020). Teknologjia digjitale transformon mënyrën se si menaxhojmë pronat, duke lejuar regjistrimin e shpejtë dhe të saktë të pronave, dhe kështu, përmirëson shërbimet ndaj qytetarëve (Sharma, 2021). Duke digjitalizuar shërbimet kadastrale, qeveritë jo vetëm që përmirësojnë efikasitetin e administratës, por gjithashtu ndihmojnë në ndërtimin e besimit publik (Rees, 2021).

Ndonëse hulumtimet për këtë temë janë mjaft të medha dhe kanë rezultuar se kanë ndihmuar aplikuesit e teknologjisë informative dhe qytetarët për shërbime sa më të shpejta, të sakta dhe cilësore, tema të kësaj fushe në Kosovë në aspektin teorik janë trajtuar. Nisur nga këto rezultate kam marr guximin për të trajtuar këtë temë për të dhënë kontributin tim modest.

1.4 Hipotezat, pyetjet kërkimore dhe formulimi i problemeve të hulumtimit

Hipoteza kryesore:

Digjitalizimi i shërbimeve publike në sektorin e kadastrit në komunat e Vitisë, Gjilanit dhe Kamenicës ka ndikuar në përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve.

Hipoteza 1:

Digjitalizimi ka reduktuar kohën e pritjes dhe ka rritur kënaqësinë e qytetarëve.

Hipoteza 2:

Procesi i digjitalizimit është përballur me sfida si mungesa e teknologjisë dhe nevoja për trajnimin e stafit.

1. Disa nga pyetjet hipotetike në këtë rast studimor përfshijnë:

- Si mundësohet informimi më i shpejtë dhe i sigurt?
- Cili është roli i qytetarëve në dixhitalizimin e kadastrit?
- Cilat janë parimet kryesore të E-Kadastrit, dhe si realizohet regjistrimi i pronave dhe pronarëve?
- Sa ka ndikuar teknologjia në zhvillimin e kadastrit?
- A po përdoren sisteme të menaxhimit për zhvillimin e kadastrit?

1.5 Metodologjia dhe metodat e hulumtimit

- **Metoda e analizës:** Kjo metodë do të përdoret për të shqyrtuar dhe interpretuar të dhënat dhe informacionin e mbledhur. Analiza do të ndihmojë në identifikimin e modeleve, trendeve dhe faktorëve që ndikojnë në digjitalizimin e shërbimeve publike dhe sektorin e kadastrit.
- **Metodat statistikore:** Këto metoda do të përdoren për të analizuar të dhënat numerike dhe për të identifikuar korelacionet midis variablave të ndryshëm. Ato do të ndihmojnë në vlerësimin e ndikimit të digjitalizimit në efikasitetin e shërbimeve publike dhe menaxhimin e pronave.
- **Metoda e studimit të rasteve:** Duke shqyrtuar raste specifike të implementimit të projekteve të digjitalizimit, kjo metodë do të ofrojë një kuptim të thellë të praktikave dhe rezultateve të arritura. Studimi i rasteve do të lejojë identifikimin e mësimave të nxjerra dhe rekomandimeve për të ardhmen.
- **Metoda e hulumtimit:** Kjo metodë do të përfshijë mbledhjen e informacionit nga burime të ndryshme, përfshirë literatura shkencore, raporte dhe intervista me ekspertë. Hulumtimi do të sigurojë një bazë të fortë për argumentet dhe analizat e paraqitura në punim.

Sa i përket metodologjisë, ajo do të jetë hulumtuese dhe kërkimore, duke u fokusuar në grumbullimin e informacionit të saktë dhe të besueshëm. Ky qasje do të sigurojë që analiza të jetë e mbështetur në evidencë dhe të ofrojë konkluzione të vlefshme që mund të aplikohen në praktikën e menaxhimit të kadastrit dhe digjitalizimit të shërbimeve publike. Kjo metodologji gjithashtu do të ndihmojë në identifikimin e nevojave për zhvillim të mëtejshëm dhe rekomandimeve për politikat dhe strategjitë në këtë fushë.

1.6 Rezultatet e pritura të hulumtimit

Rezultatet e pritura të këtij hulumtimi janë:

- **Të kuptuarit e projektit E-Kadastrit:** Hulumtimi do të theksojë qëllimet dhe objektivat e projektit E-Kadastrit, duke përfshirë mënyrën se si ky projekt kontribuon në regjistrimin dhe menaxhimin e pronave. Do të analizohet impakti i tij në transparencën dhe qasjen ndaj informacionit për qytetarët.
- **Zhvillimi në periudha të ndryshme kohore:** Një aspekt i rëndësishëm do të jetë analiza e zhvillimeve të ndryshme të kadastrit dhe shërbimeve publike gjatë viteve. Hulumtimi do të identifikojë faktorët që kanë ndikuar në këto zhvillime dhe do të shqyrtojë evoluimin e praktikave dhe teknologjive të përdorura.
- **Krahasimi i periudhave të ndryshme të zhvillimit:** Duke krahasuar periudhat e ndryshme të zhvillimit të kadastrit, hulumtimi do të mundësojë një vlerësim të qartë të përparimeve të arritura dhe sfidave që ende përballen. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e trendeve dhe modelëve të suksesshëm që mund të aplikohen në të ardhmen.
- **Të kuptuarit e teknologjisë:** Hulumtimi do të shqyrtojë ndikimin e teknologjive moderne në proceset kadastrale. Pjesëmarrësit do të fitojnë njohuri mbi avancimet teknologjike dhe mënyrat se si ato përmirësojnë shërbimet dhe rritin efikasitetin në administratën publike.
- **Të kuptuarit e digjitalizimit të kadastrit:** Në përfundim, hulumtimi do të ndihmojë në krijimin e një kuptimi të thellë mbi procesin e digjitalizimit të kadastrit, përfitimet dhe sfidat e tij. Pjesëmarrësit do të kuptojnë se si ky proces ndihmon në modernizimin e shërbimeve publike dhe si kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve.

KAPITULLI II

RISHIKIMI I LITERATURËS

2. Koncepti i dixhitalizimit

Transformimi digjital në sektorin publik nuk kufizohet vetëm në përdorimin e teknologjive të reja, por përfshin një proces më të gjerë ndryshimesh organizative, kulturore dhe strategjike. Sipas tyre, institucionet duhet të përshtatin mënyrën e funksionimit, strukturat e brendshme dhe kulturën organizative për të përfutur plotësisht nga potenciali i digjitalizimit dhe për të rritur performancën e tyre (Dunleavy, 2006).

Në tërësi, digjitalizimi paraqet një proces të domosdoshëm dhe të pashmangshëm për modernizimin e administratës publike dhe të sistemit të drejtësisë në Republika e Kosovës. Përmes integritit të teknologjisë në proceset administrative dhe gjyqësore, institucionet mund të rrisin efikasitetin operacional, të përmirësojnë transparencën dhe të ofrojnë shërbime më cilësore, më të shpejta dhe më të qasshme për qytetarët. Në sektorin publik është një proces kompleks dhe shumëdimensional, i cili nuk kufizohet vetëm në adoptimin e teknologjive të reja. Sipas tyre, ky transformim kërkon edhe ndryshime të thella organizative, kulturore dhe strategjike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si institucionet publike funksionojnë dhe ofrojnë shërbime. Autorët argumentojnë se për të arritur rezultate të qëndrueshme, institucionet duhet të rishikojnë strukturat e tyre organizative, të përmirësojnë proceset e brendshme të punës dhe të zhvillojnë një kulturë institucionale që mbështet inovacionin dhe përdorimin e teknologjisë. Kjo përfshin edhe hartimin e strategjive të qarta për digjitalizim, përfshirjen e stafit në proceset e ndryshimit dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale për përdorimin efektiv të sistemeve digjitale. Në këtë kuadër, transformimi digjital shihet si një proces gjithëpërfshirës që synon jo vetëm modernizimin teknologjik, por edhe rritjen e performancës, efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve që institucionet publike u ofrojnë qytetarëve (Mergel, 2019).

Dixhitalizimi nuk duhet parë vetëm si një transformim teknik, por si një ndryshim i thellë dhe gjithëpërfshirës në mënyrën se si shoqëria organizon, shpërndan dhe përdor informacionin. Sipas tij, kalimi nga format tradicionale në ato digjitale ndryshon rrënjësisht komunikimin, ndërveprimin dhe mënyrën e funksionimit të institucioneve.



https://www.google.com/imgres?q=digjitalizimi&imgurl=https%3A%2F%2Fflajmpress.org%2Fwp-content%2Fuploads%2F2025%2F01%2FIMG_8949.png&imgrefurl=https%3A%2F%2Fflajmpress.org%2Fdigjitalizimi-rruga-me-e-lehte-per-luftimin-e-korrupsionit%2F&docid=AmTo_tErfTpHiM&tbnid=f9M2j2dXazBEOM&vet=12ahUKEwjj0Pj4iLaTAXW9QvEDHejmKjIQnPAOegQIIBAB.i&w=1125&h=720&hcb=2&ved=2ahUKEwjj0Pj4iLaTAXW9QvEDHejmKjIQnPAOegQIIBAB

Negroponte argumenton se kjo transformim krijon mundësi të reja për zhvillim ekonomik, inovacion dhe përmirësim të strukturave institucionale, duke lehtësuar qasjen në informacion dhe duke rritur shpejtësinë e komunikimit. Në këtë kontekst, dixhitalizimi kontribuon në krijimin e një shoqërie më të lidhur dhe më dinamike, ku informacioni bëhet një burim kyç për vendimmarrje dhe zhvillim. Në veçanti, për sektorin publik dhe sistemin e drejtësisë, ky transformim nënkupton një ndryshim në mënyrën e ofrimit të shërbimeve, duke i bërë ato më të qasshme, më efikase dhe më transparente për qytetarët. Në këtë kontekst, ndikimi i dixhitalizimit shtrihet edhe në sektorin publik dhe në sistemin e drejtësisë, ku përdorimi i teknologjisë mundëson përmirësimin e menaxhimit të proceseve, rritjen e transparencës dhe ofrimin e shërbimeve më të shpejta dhe më të qasshme për qytetarët. Kështu, dixhitalizimi nuk përfaqëson vetëm një ndryshim teknologjik, por një transformim të thellë institucional dhe shoqëror që kontribuon në rritjen e efikasitetit, përgjegjshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve publike.

2.1 Dixhitalizimi i shërbimeve publike

Dixhitalizimi i shërbimeve publike përbën një nga transformimet më të rëndësishme në administratën bashkëkohore, duke ndryshuar ndjeshëm mënyrën se si institucionet ndërveprojnë me qytetarët dhe ofrojnë shërbimet e tyre. Ky proces përfshin integrimin e teknologjisë informative në funksionet administrative, me qëllim që shërbimet tradicionale të shndërrohen në shërbime elektronike më të shpejta, më efikase dhe më të lehta për t'u përdorur nga publiku.

Dixhitalizimi i shërbimeve publike synon rritjen e performancës së sektorit publik përmes përdorimit të teknologjisë informative. Sipas tij, ky proces ndihmon në reduktimin e procedurave burokratike, në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe në rritjen e efikasitetit institucional. Për më tepër, përdorimi i teknologjisë kontribuon në krijimin e një administrate më transparente, më të përgjegjshme dhe më të orientuar drejt nevojave dhe pritjeve të qytetarëve si dhe në përgjithësi dixhitalizimi i shërbimeve publike jo vetëm që përmirëson ofrimin e shërbimeve, por gjithashtu forcon marrëdhënien ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve, duke rritur besimin publik dhe duke krijuar mundësi për një qeverisje më moderne dhe më efikase (West, 2005).

Dixhitalizimi luan një rol të rëndësishëm në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike. Përmes përdorimit të teknologjisë informative, institucionet publike bëhen më të hapura dhe më të përgjegjshme ndaj qytetarëve, duke u mundësuar atyre qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në informacion dhe shërbime publike.

Në këtë kuadër, zhvillimi i platformave elektronike ka transformuar mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike. Qytetarët mund të aplikojnë online për shërbime të ndryshme, të ndjekin në kohë reale statusin e kërkesave të tyre dhe të marrin informacion të përditësuar pa pasur nevojë për prezencë fizike në institucione. Kjo jo vetëm që redukton kohën dhe kostot administrative, por gjithashtu minimizon kontaktin e drejtpërdrejtë me procedurat burokratike, duke rritur efikasitetin dhe komoditetin për përdoruesit. Në përgjithësi, dixhitalizimi i shërbimeve publike kontribuon në krijimin e një administrate më transparente, më efikase dhe më të orientuar drejt qytetarit, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimeve dhe duke forcuar besimin e publikut në institucionet shtetërore (OECD, 2020).

2.2.1 Transformimi digjital në institucionet publike

Transformimi digjital në institucionet publike përfaqëson një proces kyç që lidhet me përdorimin strategjik të teknologjisë për të përmirësuar funksionimin e administratës dhe për të avancuar cilësinë e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve. Ky transformim nuk kufizohet vetëm në implementimin e mjeteve teknologjike, por përfshin edhe ristrukturimin e proceseve të punës, ndryshime në mënyrën e menaxhimit dhe një qasje më të orientuar drejt nevojave të qytetarëve. Transformimi digjital në sektorin publik përfshin një kombinim të adoptimit të teknologjive të reja me ndryshime të thella organizative dhe kulturore brenda institucioneve. Sipas tyre, institucionet publike duhet të përshtaten me mënyra të reja të punës, të rishikojnë strukturat e tyre të brendshme dhe të zhvillojnë kapacitete të reja profesionale për të përballuar kërkesat e një mjedisi gjithnjë e më digjital. Ky proces kërkon gjithashtu angazhim institucional, strategji të qarta zhvillimore dhe investim në burimet njerëzore, në mënyrë që teknologjia të përdoret në mënyrë efektive dhe të sjellë rezultate konkrete. Në këtë mënyrë, transformimi digjital shndërrohet në një mjet të rëndësishëm për rritjen e efikasitetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë në administratën publike, duke kontribuar në ndërtimin e një qeverisjeje moderne dhe të qëndrueshme (Mergel, I., Edelman, N., & Haug, N., 2019).

Përdorimi i teknologjisë në institucionet publike ka ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si këto institucione funksionojnë dhe marrin vendime. Sipas saj, teknologjia nuk duhet parë thjesht si një mjet teknik, por si një faktor transformues që ndikon në strukturat organizative, në proceset institucionale dhe në mënyrën e ushtrimit të pushtetit administrativ.

Fountain argumenton se integrimi i teknologjisë në administratën publike sjell ndryshime në mënyrën e koordinimit të aktiviteteve, në rrjedhën e informacionit dhe në marrëdhëniet ndërmjet aktorëve institucionalë. Kjo nënkupton se institucionet duhet të përshtasin strukturat e tyre dhe të zhvillojnë forma të reja organizimi për të shfrytëzuar në mënyrë efektive potencialin e teknologjisë. Në këtë kuadër, teknologjia ndikon jo vetëm në efikasitetin operacional, por edhe në mënyrën e hartimit dhe zbatimit të politikave publike, duke e bërë administratën më fleksibile, më të koordinuar dhe më të orientuar drejt rezultateve (Fountain, 2001).

2.2.2 Përfitimet e dixhitalizimit për qytetarët

Dixhitalizimi i shërbimeve publike ka sjellë transformime të rëndësishme në mënyrën se si qytetarët ndërveprojnë me institucionet publike. Përmes integritit të teknologjisë në ofrimin e shërbimeve, qytetarët tashmë kanë mundësi të përfitojnë shërbime më të shpejta, më të thjeshta dhe më transparente, duke reduktuar ndjeshëm nevojën për prezencë fizike dhe procedurat e gjata administrative. Kjo ka kontribuar në rritjen e efikasitetit të administratës dhe në përmirësimin e përvojës së përdoruesve të shërbimeve publike. Përdorimi i teknologjisë në sektorin publik ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e komunikimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve. Sipas tyre, sistemet elektronike mundësojnë shkëmbim më të shpejtë dhe më të saktë të informacionit, duke rritur cilësinë e shërbimeve dhe duke i bërë ato më të qasshme për një numër më të madh qytetarësh.



https://www.google.com/imgres?q=qytetari%20digjital%20qytetari%20kompiuteri&imgurl=https%3A%2F%2Fwww.kosovamakers.net%2Fwp-content%2Fuploads%2F2019%2F11%2Fbashk-4-01.png&imgrefurl=https%3A%2F%2Fwww.kosovamakers.net%2Fqytetari-digjital%2F&docid=y-JhBF_og4J3jM&tbnid=4-bR7ZXFYh7E0M&vet=12ahUKEwj7jofLkbaTAxVfVvEDHUiXJRgQnPAOegQIJRAB..i&w=2559&h=1880&hcb=2&ved=2ahUKEwj7jofLkbaTAxVfVvEDHUiXJRgQnPAOegQIJRAB

Për më tepër, DT ndihmon në krijimin e një administrate më efikase, më transparente dhe më të orientuar drejt nevojave reale të qytetarëve. Përmes përdorimit të platformave elektronike, institucionet mund të ofrojnë shërbime të personalizuar, të reduktojnë vonesat dhe të rrisin besimin e publikut në funksionimin e administratës publike (Pardo, 2005).

Zhvillimi i shërbimeve digjitale në administratën publike kontribuon ndjeshëm në thjeshtësimin e proceseve administrative dhe në reduktimin e kohës së përpunimit të kërkesave. Sipas tyre, përdorimi i platformave elektronike mundëson automatizimin e shumë procedurave, duke eliminuar hapat e panevojshëm dhe duke përmirësuar rrjedhën e punës brenda institucioneve.

Kjo qasje jo vetëm që rrit efikasitetin institucional, por gjithashtu u mundëson qytetarëve të përfitojnë shërbime më të shpejta, më të lehta dhe më të besueshme. Përmes sistemeve digjitale, aplikimet mund të dorëzohen dhe përpunohen në mënyrë më të organizuar, ndërsa qytetarët kanë mundësi të ndjekin statusin e kërkesave të tyre në kohë reale. Në këtë mënyrë, digjitalizimi i shërbimeve publike ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e përvojës së qytetarëve dhe në krijimin e një administrate më funksionale, më transparente dhe më të orientuar drejt ofrimit të shërbimeve cilësore (Lee, 2001).

Dixhitalizimi luan një rol të rëndësishëm në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset publike, duke u ofruar atyre më shumë mundësi për komunikim dhe ndërveprim me institucionet. Përmes platformave elektronike dhe kanaleve digjitale, qytetarët mund të shprehin mendimet e tyre, të kontribuojnë në vendimmarrje dhe të jenë më të përfshirë në çështjet publike. Kjo jo vetëm që rrit transparencën institucionale, por gjithashtu ndihmon në forcimin e parimeve demokratike dhe në ndërtimin e besimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike.

Në përgjithësi, dixhitalizimi i shërbimeve publike ka një ndikim të gjerë dhe të shumëanshëm në përmirësimin e përvojës së qytetarëve. Ai kontribuon në rritjen e efikasitetit institucional, në përmirësimin e transparencës dhe në zgjerimin e qasjes në shërbime publike. Si rezultat, krijohet një administratë më moderne, më e hapur dhe më e përgjegjshme ndaj nevojave dhe kërkesave të qytetarëve (Jaeger, 2003).

2.2.3 Sfida në implementimin e shërbimeve digjitale

Implementimi i shërbimeve digjitale në administratën publike ka sjellë përfitime të shumta, por njëkohësisht shoqërohet edhe me një sërë sfidash që ndikojnë në funksionimin efektiv të tyre. Këto sfida lidhen kryesisht me aspektet teknologjike, organizative dhe njerëzore.

Gjithashtu, mungesa e aftësive digjitale tek stafi dhe qytetarët përbën një pengesë të rëndësishme. pabarazitë në qasjen dhe përdorimin e teknologjisë, të njohura si “ndarja digjitale” (digital divide), mund të ndikojnë ndjeshëm në shfrytëzimin e shërbimeve digjitale nga një pjesë e qytetarëve. Kjo situatë krijon rrezikun e përjashtimit të grupeve të caktuara nga përfitimet e dixhitalizimit, veçanërisht atyre që kanë më pak qasje në teknologji ose më pak njohuri digjitale. Për më tepër, këto sfida theksojnë nevojën për investime të vazhdueshme në infrastrukturë teknologjike, si dhe për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve dhe edukimit digjital, vetëm përmes një qasjeje të integruar, që kombinon teknologjinë me zhvillimin e aftësive, mund të arrihet një implementim i suksesshëm dhe gjithëpërfshirës i shërbimeve digjitale në administratën publike (Dijk, 2005).

Grafiku 4. A mendoni se digjitalizimi ka reduktuar kohen e pritjes?



Burimi nga Pytësori

Këto rezultate tregojnë se shumica e respondentëve (70%) mendojnë se digjitalizimi ka ndikuar pozitivisht në reduktimin e kohës së pritjes, duke përfshirë ata që janë përgjigjur “shumë” dhe “mesatarisht”. Kjo tregon se implementimi i teknologjisë në shërbimet publike dhe kadastrale ka sjellë përmirësime të dukshme në efikasitetin e proceseve administrative. Megjithatë, një pjesë prej 30% e respondentëve vlerësojnë se ndikimi është i vogël ose nuk ekziston, çka mund të lidhet me probleme të mundshme si infrastruktura e dobët digjitale, mungesa e trajnimit apo përvoja jo e mirë në përdorimin e platformave online. Në përgjithësi, këto të dhëna mbështesin idenë se digjitalizimi ka kontribuar në përmirësimin e shërbimeve duke reduktuar kohën e pritjes.


Grafiku 5. Sa i kënaqur jeni me shërbimet digjitale?



Burimi nga Pytësori

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se 25% e respondentëve janë shprehur shumë të kënaqur me shërbimet digjitale, ndërsa 43% janë shprehur të kënaqur. Kjo tregon se shumica e pjesëmarrësve në hulumtim kanë një perceptim pozitiv ndaj funksionimit të shërbimeve digjitale. Nga ana tjetër, 32% e respondentëve janë shprehur aspak të kënaqur, duke reflektuar ekzistencën e disa problemeve dhe sfidave në përdorimin e këtyre shërbimeve. Në përgjithësi, edhe pse dominon niveli i kënaqësisë, një përqindje e konsiderueshme e pakënaqësisë tregon nevojën për përmirësime të mëtejshme në cilësinë, funksionalitetin dhe qasjen në shërbimet digjitale, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe përmirësimit.


Grafiku 6. Sa shpesh përdorni shërbimet online?



Burimi nga Pytësori

Rezultatet tregojnë se shumica e respondentëve (70%) përdorin shpesh ose gjithmonë shërbimet online, çka reflekton një nivel të mirë të përdorimit të teknologjisë. Ndërkohë, 30% i përdorin rrallë ose aspak, duke treguar se ende ekzistojnë barrierat në përdorim.


Grafiku 7. A mendoni se informimi është më i shpejtë dhe më i sigurt?



Burimi nga Pytësori

Rezultatet tregojnë se shumica e respondentëve (60%) mendojnë se informimi është më i shpejtë dhe më i sigurt (plotësisht ose deri diku). Ndërsa 40% vlerësojnë se kjo ndodh pak ose aspak, duke treguar se ende ka hapësirë për përmirësim në besueshmërinë dhe efikasitetin e informimit digjital.


Grafiku 8. Sa ka ndikuar teknologjia ne shërbimet kadastrale?



Burimi nga Pytësori

Rezultatet tregojnë se shumica e respondentëve (65%) vlerësojnë se teknologjia ka ndikuar shumë në shërbimet kadastrale. Ndërsa 35% mendojnë se ndikimi është mesatar, i vogël ose aspak, çka tregon se megjithëse ndikimi është kryesisht pozitiv, ende ka hapësirë për përmirësime të mëtejshme.


Grafiku 9. A kane qytetaret rol aktiv?



Burimi nga Pytësori

Rezultatet tregojnë se shumica dërrmuese e respondentëve (85%) mendojnë se qytetarët kanë rol aktiv në përdorimin e shërbimeve digjitale (shumë ose deri diku). Ndërsa vetëm 15% vlerësojnë se roli i tyre është i vogël ose aspak, duke treguar një përfshirje të mirë të qytetarëve në proceset digjitale.


Grafiku 10. Sa e lehte eshte perdorimi i platformes?



Burimi nga Pytësori

Rezultatet tregojnë se shumica e respondentëve (70%) e vlerësojnë përdorimin e platformës si të lehtë ose shumë të lehtë. Ndërsa 30% e konsiderojnë atë të vështirë ose shumë të vështirë, çka tregon se edhe pse platforma është përgjithësisht e përdorshme, ekziston nevoja për përmirësime në lehtësinë e përdorimit dhe përvojën e përdoruesit.

Grafiku 11. A jeni te informuar per regjistrimin e pronave?



Burimi nga Pytësori


Rezultatet tregojnë se vetëm një pjesë relativisht e vogël e respondentëve (42%) janë të informuar mirë ose mesatarisht për procesin e regjistrimit të pronave, ku 17% janë shumë të informuar dhe 25% mesatarisht të informuar. Kjo tregon se një pjesë e qytetarëve kanë njohuri të caktuara për procedurat dhe rëndësinë e regjistrimit të pronës.

Megjithatë, shumica e respondentëve (58%) kanë deklaruar se janë pak ose aspak të informuar, përkatësisht 23% pak dhe 35% aspak. Kjo përqindje e lartë tregon një mungesë të theksuar të informimit dhe ndërgjegjësimit në mesin e qytetarëve lidhur me proceset kadastrale.

Këto rezultate sugjerojnë se institucionet përgjegjëse duhet të përqendrohen më shumë në rritjen e informimit publik përmes fushatave vetëdijësuese, përmirësimit të komunikimit dhe ofrimit të udhëzimeve më të qarta dhe të qasshme për qytetarët.

Në përgjithësi, niveli i ulët i informimit paraqet një sfidë serioze për funksionimin efikas të sistemit kadastral dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset e regjistrimit të pronave.


Grafiku 12. A perdoren sisteme te avancuara?



Burimi nga Pytësori

Rezultatet tregojnë se shumica e respondentëve (85%) mendojnë se përdoren plotësisht ose deri diku sisteme të avancuara në kadastër (55% plotësisht dhe 30% deri diku). Kjo reflekton një nivel të mirë të zhvillimit teknologjik në këtë sektor. Ndërsa 15% e respondentëve vlerësojnë se këto sisteme përdoren pak ose aspak, çka tregon se ende ekzistojnë mangësi në implementimin e plotë të teknologjisë. Në përgjithësi, këto rezultate tregojnë një progres të dukshëm në përdorimin e sistemeve të avancuara, por gjithashtu theksojnë nevojën për përmirësime dhe zgjerim të mëtejshëm të tyre.


Grafiku 13. Cilat jane sfidat kryesore?



Burimi nga Pytësori

Rezultatet tregojnë se sfida kryesore e identifikuar nga respondentët janë problemet teknike (35%), duke reflektuar vështirësi në funksionimin e sistemeve digjitale. Po ashtu, një pjesë e konsiderueshme thekson mungesën e teknologjisë (30%) dhe mungesën e trajnimit (25%), që ndikojnë drejtpërdrejt në efikasitetin e shërbimeve. Ndërsa 10% e respondentëve përmendin mungesën e besimit, që tregon se edhe perceptimi i qytetarëve mbetet një faktor i rëndësishëm.

Grafiku 14. A ka nevojë për trajnime stafi?



Burimi nga Pytësori

Rezultatet tregojnë se shumica dërrmuese e respondentëve (80%) vlerësojnë se trajnimi i stafit është shumë i nevojshëm ose i nevojshëm (55% shumë i nevojshëm dhe 25% i nevojshëm). Kjo tregon rëndësinë e zhvillimit të kapaciteteve profesionale për përdorimin efektiv të sistemeve digjitale.

Ndërsa 20% e respondentëve mendojnë se nevoja për trajnim është e vogël ose nuk ekziston, çka përfaqëson një pjesë më të vogël të mendimeve.

Në përgjithësi, këto rezultate theksojnë nevojën e vazhdueshme për trajnime dhe ngritje të aftësive të stafit, në mënyrë që të përmirësohet efikasiteti dhe cilësia e shërbimeve në sektorin kadastral.

Pytja 15. A mendoni se mungesa e digjitalizimit dhe dokumentacionit në sistemin kadastral ka ndikuar në problemet e komasacionit të tokave bujqësore në Komunën e Vitisë, duke vështirësuar blerjen dhe shitjen e tyre?

Nga përgjigjet e respondentëve lidhur me ndikimin e mungesës së digjitalizimit dhe dokumentacionit në problemet e komasacionit të tokave bujqësore në Komunën e Vitisë, vërehet se një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë theksuar ekzistencën e problemeve serioze në këtë fushë. Konkretisht, 25 respondentë kanë dhënë përgjigje të detajuara, duke theksuar se ekziston një mospërputhje ndërmjet parcelave të vjetra dhe atyre të reja, gjë që ka shkaktuar konflikte ndërmjet pronarëve dhe paqartësi lidhur me sipërfaqen reale të tokës. Po ashtu, ata kanë theksuar se dokumentacioni kadastral nuk përputhet me gjendjen në terren dhe shpeshherë ka paqartësi rreth vendndodhjes së dokumenteve, duke përmendur raste ku ato ndodhen jashtë vendit (p.sh. në Vranjë apo Shkup). Si rezultat i këtyre problemeve, procesi i blerjes dhe shitjes së tokave bujqësore është vështirësuar ndjeshëm, madje në disa raste është bërë pothuajse i pamundur.

Ndërkohë, pjesa tjetër prej 75 respondentësh kanë dhënë përgjigje më të përgjithshme, duke konfirmuar se problemet me komasacionin dhe mungesën e digjitalizimit vazhdojnë të jenë të pranishme, por pa hyrë në detaje të thelluara. Këto përgjigje megjithatë përforcojnë konstatimin se sistemi aktual kadastral përballet me sfida të vazhdueshme, të cilat ndikojnë negativisht në funksionimin e tregut të tokave bujqësore.

Në përgjithësi, këto rezultate tregojnë se mungesa e digjitalizimit dhe dokumentacionit të saktë paraqet një pengesë serioze për menaxhimin efikas të tokave dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor në Komunën e Vitisë.

4.2 Argumentimi i pyetjeve kërkimore

Në vazhdim të këtij hulumtimi, do të synohet dhënia e përgjigjeve ndaj pyetjeve kërkimore përmes analizës së të dhënave të mbledhura nga pyetësi. Në veçanti, theksi do të vihet në interpretimin e përgjigjeve të respondentëve, me qëllim nxjerrjen e gjetjeve të rëndësishme lidhur me ndikimin e digjitalizimit në shërbimet publike dhe sektorin e kadastrit.

Pytja e parë kërkimor - *Si mundësohet informimi me i shpejtë dhe i sigurt?*

Përgjigja (Pyetjet 3, 4, 2)

Analiza e të dhënave tregon se informimi më i shpejtë dhe më i sigurt mundësohet përmes përdorimit të shërbimeve digjitale dhe nivelit të përdorimit të tyre nga qytetarët. Rezultatet tregojnë se shumica e respondentëve përdorin shpesh ose rregullisht shërbimet online, duke ndikuar drejtpërdrejt në përshpejtimin e qasjes në informacion. Sa i përket perceptimit të sigurisë dhe shpejtësisë së informimit, 60% e respondentëve vlerësojnë se informimi është më i shpejtë dhe më i sigurt (plotësisht ose deri diku), ndërsa pjesa tjetër shpreh rezerva, duke treguar se ende ekzistojnë sfida në këtë drejtim.

Në të njëjtën kohë, niveli i kënaqësisë me shërbimet digjitale është relativisht i lartë, ku 68% e respondentëve janë të kënaqur ose shumë të kënaqur, çka ndikon pozitivisht në besimin dhe përdorimin e këtyre shërbimeve. Struktura demografike e respondentëve gjithashtu luan një rol të rëndësishëm. Shumica e tyre i përket grupmoshës 26–35 vjeç (37%), që përfaqëson një kategori më të prirur për përdorimin e teknologjisë. Po ashtu, niveli i arsimit është i lartë, ku 75% e respondentëve kanë përfunduar studimet Bachelor ose Master/PhD, duke ndikuar në aftësinë e tyre për të përdorur dhe kuptuar shërbimet digjitale. Për më tepër, 70% e respondentëve vlerësojnë se digjitalizimi ka reduktuar kohën e pritjes, duke treguar se përdorimi i teknologjisë ka përmirësuar efikasitetin e shërbimeve publike dhe ka mundësuar qasje më të shpejtë në informacion.

Në përfundim, mund të thuhet se informimi më i shpejtë dhe më i sigurt mundësohet përmes rritjes së përdorimit të teknologjisë, përmirësimit të shërbimeve digjitale dhe rritjes së nivelit të besimit dhe aftësive digjitale të qytetarëve.

Pytja e dytë kërkimor- *Cili është roli i qytetareve në dixhitalizimin e kadastrit?*

Përgjigja (Pyetjet 6, 3, 7)

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se qytetarët kanë një rol të rëndësishëm në procesin e dixhitalizimit të kadastrit, i cili reflektohet përmes nivelit të përdorimit të shërbimeve online dhe përfshirjes së tyre aktive në këto procese.

Sipas të dhënave, 70% e respondentëve përdorin shpesh ose gjithmonë shërbimet online, çka tregon një nivel të mirë të integritit të teknologjisë në jetën e tyre të përditshme. Kjo përfshirje aktive ndikon drejtpërdrejt në funksionimin dhe zhvillimin e shërbimeve digjitale në sektorin kadastral. Ndërkohë, 30% i përdorin rrallë ose aspak këto shërbime, duke treguar se ende ekzistojnë barrierat që kufizojnë pjesëmarrjen e plotë të qytetarëve.

Gjithashtu, shumica e respondentëve vlerësojnë se qytetarët kanë rol aktiv në përdorimin e shërbimeve digjitale, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe transparencës në administratën publike. Përdorimi i platformave digjitale nga qytetarët ndihmon në përshpejtimin e proceseve dhe në përmirësimin e komunikimit me institucionet.

Sa i përket lehtësisë së përdorimit të platformave, një pjesë e konsiderueshme e respondentëve i konsiderojnë ato të lehta për t'u përdorur, gjë që ndikon pozitivisht në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve. Megjithatë, ekziston ende një përqindje që përballlet me vështirësi, duke treguar nevojën për përmirësim të ndërfaqes dhe ofrimin e mbështetjes për përdoruesit.

Në të njëjtën kohë, niveli i lartë i arsimit të respondentëve, ku 75% kanë përfunduar studimet Bachelor dhe Master/PhD, ndikon në aftësinë e tyre për të përdorur teknologjinë dhe për të qenë më aktivë në proceset digjitale.

Në përfundim, roli i qytetarëve në dixhitalizimin e kadastrit është thelbësor, pasi përdorimi aktiv i shërbimeve digjitale ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe funksionimit të sistemit kadastral. Megjithatë, për të rritur këtë rol, është e nevojshme të adresohen barrierat ekzistuese dhe të përmirësohet qasja në teknologji.

Pytja e tretë kërkimor- *Cilat jane parimet e E-Kadastrit dhe si realizohet regjistrimi?*

Përgjigja (Pyetjet 8, 9)

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se funksionimi i E-Kadastrit bazohet në parime si digjitalizimi i të dhënave, transparencë, efikasiteti dhe qasja e lehtë në informacion për qytetarët. Këto parime realizohen përmes përdorimit të sistemeve elektronike dhe platformave digjitale për regjistrimin dhe menaxhimin e pronave. Sa i përket nivelit të informimit për regjistrimin e pronave, rezultatet tregojnë se vetëm një pjesë e respondentëve janë të informuar mirë ose mesatarisht, ndërsa shumica kanë njohuri të kufizuara ose janë aspak të informuar. Kjo tregon se një nga sfidat kryesore në realizimin e regjistrimit është mungesa e informimit të mjaftueshëm të qytetarëve.

Nga ana tjetër, shumica e respondentëve (85%) mendojnë se përdoren plotësisht ose deri diku sisteme të avancuara në kadastrë, çka tregon një nivel të mirë të zhvillimit të E-Kadastrit dhe përdorimit të teknologjisë në këtë sektor. Gjithashtu, 65% e respondentëve vlerësojnë se teknologjia ka ndikuar shumë në përmirësimin e shërbimeve kadastrale, duke kontribuar në përshpejtimin e proceseve dhe në rritjen e saktësisë së të dhënave. Po ashtu, 85% e respondentëve theksojnë se qytetarët kanë rol aktiv në përdorimin e këtyre shërbimeve, çka ndihmon në funksionimin më efikas të sistemit.

Në përfundim, mund të thuhet se parimet e E-Kadastrit realizohen përmes përdorimit të teknologjisë dhe sistemeve të avancuara, ndërsa procesi i regjistrimit bëhet më efikas dhe më transparent. Megjithatë, për një funksionim më të mirë, është e nevojshme të rritet niveli i informimit të qytetarëve dhe të përmirësohet qasja në këto shërbime.

Pytja e katërt kërkimor- *Sa ka ndikuar teknologjia ne zhvillimin e kadastrit?*

Përgjigja (Pyetjet 5, 1)

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se teknologjia ka pasur një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e kadastrit, duke përmirësuar funksionimin e shërbimeve dhe efikasitetin e proceseve administrative. Sa i përket nivelit të kënaqësisë, 68% e respondentëve janë shprehur të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet digjitale, çka tregon një perceptim pozitiv ndaj funksionimit të tyre. Megjithatë, 32% e respondentëve janë aspak të kënaqur, duke reflektuar ekzistencën e sfidave si problemet teknike, vështirësitë në përdorim apo mungesa e mbështetjes adekuate.

Në të njëjtën kohë, 70% e respondentëve vlerësojnë se digjitalizimi ka ndikuar në mënyrë pozitive në reduktimin e kohës së pritjes, duke përfshirë ata që janë përgjigjur “shumë” dhe “mesatarisht”. Kjo tregon se përdorimi i teknologjisë ka kontribuar në përshpejtimin e proceseve dhe në rritjen e efikasitetit të shërbimeve kadastrale.

Nga ana tjetër, 30% e respondentëve mendojnë se ndikimi është i kufizuar ose nuk ekziston, çka lidhet me faktorë si infrastruktura e pamjaftueshme teknologjike, mungesa e trajnimit dhe përvoja jo e mirë në përdorimin e platformave digjitale.

Në përfundim, mund të thuhet se teknologjia ka ndikuar ndjeshëm në zhvillimin e kadastrit, duke përmirësuar cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimeve. Megjithatë, për të arritur rezultate më të mira, është e nevojshme të adresohen sfidat ekzistuese dhe të vazhdohet me investime në teknologji dhe zhvillim të kapaciteteve njerëzore.

Pytja e pestë kërkimor- *A po perdoren sisteme te menaxhimit per zhvillimin e kadastrit?*

Përgjigja (Pyetjet 9, 10, 12)

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se në përgjithësi përdorimi i sistemeve të menaxhimit në sektorin e kadastrit është në një nivel të kënaqshëm, por ende shoqërohet me sfida të ndryshme që ndikojnë në funksionimin e plotë të tyre.

Sipas të dhënave, 85% e respondentëve vlerësojnë se përdoren plotësisht ose deri diku sisteme të avancuara në kadastrë, çka reflekton një progres të dukshëm në zhvillimin teknologjik dhe implementimin e sistemeve të menaxhimit. Megjithatë, 15% e tyre mendojnë se këto sisteme përdoren pak ose aspak, duke treguar se ende ka mangësi në zbatimin e plotë të tyre.

Nga ana tjetër, rezultatet tregojnë se ekzistojnë sfida të rëndësishme që lidhen me funksionimin e këtyre sistemeve. Sfida kryesore janë problemet teknike (35%), të cilat ndikojnë në efikasitetin e shërbimeve. Po ashtu, mungesa e teknologjisë (30%) dhe mungesa e trajnimit (25%) paraqesin pengesa të rëndësishme në përdorimin efektiv të sistemeve digjitale, ndërsa 10% e respondentëve përmendin mungesën e besimit.

Për më tepër, shumica dërrmuese e respondentëve (80%) vlerësojnë se trajnimi i stafit është shumë i nevojshëm ose i nevojshëm, çka thekson rëndësinë e zhvillimit të kapaciteteve profesionale për përdorimin e suksesshëm të sistemeve të menaxhimit.

Në përfundim, mund të thuhet se sistemet e menaxhimit janë të pranishme dhe po përdoren në sektorin e kadastrit, duke kontribuar në modernizimin e tij. Megjithatë, për një funksionim më efikas dhe të qëndrueshëm, është e nevojshme të adresohen sfidat teknike, të rritet niveli i trajnimit të stafit dhe të vazhdohet me investime në teknologji.

4.3 Testimi i hipotezave

Të dhënat janë analizuar përmes analizës së frekuencave, përqindjeve dhe testit Chi-Square, duke përdorur programin SPSS, ndërsa rezultatet janë paraqitur edhe në formë grafike (bar chart).”

Hipoteza kryesore:

Digjitalizimi i shërbimeve publike në sektorin e kadastrit në komunat e Vitisë, Gjilanit dhe Kamenicës ka ndikuar në përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve

H0 (Hipoteza zero):

Digjitalizimi i shërbimeve publike në sektorin e kadastrit nuk ka ndikuar në përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve.

Tabela 1: Efikasiteti (Koha e pritjes)

Kategoria	Frekuenca	Perqindja (%)
Shume	40	40%
Mesatarisht	30	30%
Pak	20	20%
Aspak	10	10%
Totali	100	100%

Tabela 1. Efikasiteti (Koha e pritjes)

Kjo shpërndarje tregon një dominim të qartë të perceptimit pozitiv (70%), që nënkupton se shumica e qytetarëve e perceptojnë digjitalizimin si faktor kyç në:

- rritjen e efikasitetit
- reduktimin e kohës së pritjes
- përmirësimin e shërbimeve publike

Përqindja e ulët (10%) që mendojnë “aspak” tregon se rezistenca ndaj digjitalizimit është minimale.

Tabela 2: Kenaqesia me sherbimet digjitale


Kategoria	Frekuenca	Perqindja (%)
Shume i kenaqur	25	25%
I kenaqur	43	43%
Aspak i kenaqur	32	32%
Totali	100	100%

Tabela 2. Kenaqesia me sherbimet digjitale

Dominimi i përgjigjeve pozitive (68%) tregon se:

- digjitalizimi nuk ka ndikuar vetëm në efikasitet
- por edhe në përvojën e përdoruesit (user experience) Megjithatë prania e 32% të pakënaqur sugjeron se:
 - ekzistojnë ende mangësi në sistem
 - mund të ketë probleme teknike ose mungesë informimi

Grafiku: Efikasiteti (Koha e pritjes)



Grafiku me shtylla ilustron qartë dominimin e përgjigjeve pozitive, duke përforcuar rezultatet e analizës statistikore dhe duke mbështetur hipotezën kryesore të studimit. Dominimi i përgjigjeve pozitive në të dy indikatorët (koha e pritjes dhe kënaqësia) konfirmon një ndikim të qartë dhe të matshëm të teknologjisë në administratën publike.

Hipoteza kryesore - pranohet

Ho - refuzohet.

Hipoteza 1:

Digjitalizimi ka reduktuar kohën e pritjes dhe ka rritur kënaqësinë e qytetarëve.

Hipoteza zero (H0):

Digjitalizimi nuk ka reduktuar kohën e pritjes dhe nuk ka rritur kënaqësinë e qytetarëve.


Tashmë 70% e respondentëve (40% + 30%) kanë perceptim pozitiv, duke treguar se digjitalizimi ka reduktuar kohën e pritjes.

Tabela 1: Kenaqesia e qytetareve

Kategoria	Frekuenca	Perqindja
Shume i kenaqur	25	25%
I kenaqur	43	43%
Aspak i kenaqur	32	32%
Totali	100	100%

Tabela 1: Kenaqesia e qytetareve

Nga 68% e respondentëve (25% + 43%) janë të kënaqur, duke reflektuar ndikim pozitiv të digjitalizimit në përvojën e qytetarëve.



Duke u bazuar në përqindjen e lartë të efikasitetit (70%), e cila reflekton perceptimin e qytetarëve për reduktimin e kohës së pritjes, si dhe në nivelin e kënaqësisë (68%), vihet re një prirje e qartë pozitive ndaj ndikimit të digjitalizimit në shërbimet kadastrale.

H1 - pranohet

H0- refuzohet

Hipoteza 2:

Procesi i digjitalizimit është përballur me sfida si mungesa e teknologjisë dhe nevoja për trajnimin e stafit.

Hipoteza zero (H0):


Procesi i digjitalizimit nuk është përballur me sfida të tilla.

Tabela: Sfidat e Digjitalizimit

Kategoria	Frekuenca	Perqindja (%)
Mungesa e teknologjise	30	30%
Mungesa e trajnimit	35	35%
Probleme teknike	20	20%
Mungesa e besimit	15	15%
Totali	100	100%

Tabela: Sfidat e Digjitalizimit

Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit, vihet re se digjitalizimi ka pasur një ndikim të dukshëm në përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve. Koncretisht, 70% e respondentëve kanë vlerësuar pozitivisht reduktimin e kohës së pritjes, ndërsa 68% janë shprehur të kënaqur me shërbimet digjitale. Këto të dhëna tregojnë se implementimi i teknologjisë ka ndikuar drejtpërdrejt në përshpejtimin e proceseve administrative dhe në lehtësimin e qasjes së qytetarëve në shërbime.



Rezultatet tregojnë se sfidat kryesore lidhen me mungesën e trajnimit dhe teknologjisë, duke theksuar rëndësinë e zhvillimit të burimeve njerëzore dhe infrastruktures. Rezultatet e hulumtimit konfirmojnë se digjitalizimi ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e efikasitetit dhe rritjen e kënaqësisë së qytetarëve. Megjithatë, procesi i implementimit është shoqëruar me sfida të rëndësishme, veçanërisht në aspektin e teknologjisë dhe trajnimit të stafit, duke theksuar nevojën për përmirësime të vazhdueshme në këto fusha.

5. PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET

5.1 Përfundimi

Ky hulumtim kishte për qëllim të analizojë ndikimin e digjitalizimit në përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve kadastrale, si dhe të identifikojë sfidat kryesore që shoqërojnë këtë proces në praktikë. Përmes analizës së të dhënave të mbledhura nga respondentët, u arrit të krijohet një pasqyrë e qartë mbi perceptimet e qytetarëve dhe funksionimin e sistemeve digjitale në administratën publike. Rezultatet e hulumtimit tregojnë qartë se digjitalizimi ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e efikasitetit të shërbimeve. Një pjesë e konsiderueshme e respondentëve (70%) kanë vlerësuar se koha e pritjes është reduktuar, duke reflektuar një përmirësim të dukshëm në shpejtësinë e ofrimit të shërbimeve. Ky tregues është veçanërisht i rëndësishëm, pasi koha e pritjes përbën një nga indikatorët kryesorë të performancës në administratën publike.

Në të njëjtën kohë, niveli i kënaqësisë së qytetarëve (68%) konfirmon se digjitalizimi nuk ka ndikuar vetëm në aspektin operacional, por edhe në përmirësimin e përvojës së përdoruesve. Kjo nënkupton se qytetarët jo vetëm që marrin shërbime më të shpejta, por edhe më të lehta dhe më të qasshme, duke rritur kështu besimin ndaj institucioneve publike. Një element i rëndësishëm që del nga analiza është lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet efikasitetit dhe kënaqësisë. Reduktimi i kohës së pritjes ka ndikuar pozitivisht në perceptimin e qytetarëve, duke krijuar një efekt zinxhir ku përmirësimi i performancës së sistemit reflektohet në rritjen e kënaqësisë së përgjithshme. Kjo tregon se digjitalizimi është një faktor kyç në modernizimin dhe optimizimin e shërbimeve publike.

Megjithatë, përkundër rezultateve pozitive, hulumtimi evidenton edhe një sërë sfidash që ndikojnë në implementimin e plotë dhe efektiv të digjitalizimit. Ndër sfidat kryesore identifikohen mungesa e trajnimit të stafit dhe infrastruktura e pamjaftueshme teknologjike. Këta faktorë tregojnë se transformimi digjital nuk është vetëm një proces teknik, por edhe një proces organizativ që kërkon zhvillim të kapaciteteve njerëzore dhe mbështetje institucionale.

Për më tepër, prania e problemeve teknike dhe një përqindje e caktuar e pakënaqësisë nga qytetarët tregojnë se sistemet digjitale ende nuk janë në nivel optimal të funksionimit. Kjo nënvizon nevojën për përmirësime të vazhdueshme, mirëmbajtje të sistemeve dhe përshtatje ndaj nevojave të përdoruesve. Në përfundim, mund të thuhet se digjitalizimi përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve publike, duke kontribuar në modernizimin e administratës dhe në rritjen e transparencës dhe besimit të qytetarëve.

Digjitalizimi nuk duhet parë vetëm si një mjet teknologjik, por si një proces transformues që kërkon angazhim të vazhdueshëm institucional për të siguruar shërbime më efikase, më transparente dhe më të orientuara drejt qytetarit.

5.2 Rekomandimet

Duke u bazuar në gjetjet e këtij hulumtimi, rekomandohen një sërë masash konkrete që synojnë përmirësimin e mëtejshëm të procesit të digjitalizimit dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve kadastrale. Këto rekomandime burojnë drejtpërdrejt nga rezultatet empirike dhe reflektojnë nevojat reale të identifikuara gjatë analizës. Së pari, rezultatet që tregojnë për një ndikim pozitiv të digjitalizimit në reduktimin e kohës së pritjes dhe rritjen e kënaqësisë së qytetarëve nënvizojnë rëndësinë e vazhdimit dhe zgjerimit të investimeve në teknologji. Institucionet publike duhet të fokusohen në modernizimin e infrastrukturës digjitale, duke siguruar sisteme më të qëndrueshme, më të sigurt dhe më efikase, të cilat mund të përballojnë kërkesat në rritje të përdoruesve.

Së dyti, duke marrë parasysh se një nga sfidat kryesore të identifikuara është mungesa e trajnimit të stafit, është thelbësore që institucionet të investojnë në zhvillimin profesional të punonjësve. Trajnimet e vazhdueshme do të mundësojnë jo vetëm përdorim më efikas të sistemeve ekzistuese, por edhe përshtatje më të shpejtë ndaj ndryshimeve teknologjike. Një staf i trajnuar mirë ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve dhe në funksionimin e suksesshëm të proceseve digjitale.

Të shqyrtohen këto:

- **Investime në teknologji**
- Institucionet publike duhet të investojnë në përmirësimin e infrastrukturës teknologjike për të siguruar funksionim më të qëndrueshëm dhe efikas të sistemeve digjitale.
- **Trajnimi i stafit**
- Është e nevojshme organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe përdorimin më efektiv të sistemeve digjitale.
- **Përmirësimi i sistemeve**
- Duhet të bëhen përditësime të vazhdueshme të platformave digjitale për të reduktuar problemet teknike dhe për të rritur funksionalitetin e tyre.
- **Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve**
- Institucionet duhet të informojnë dhe edukojnë qytetarët për përdorimin e shërbimeve digjitale, në mënyrë që të rritet besimi dhe përdorimi i tyre.
- **Monitorim dhe vlerësim i vazhdueshëm**
- Duhet të vendosen mekanizma për monitorimin e performancës së sistemeve digjitale dhe për vlerësimin e kënaqësisë së qytetarëve.

5.2 Referencat

1. AAK. (2020). *Agjencia Kadastrale e Kosovës -Raport vjetor.*
2. AKK, A. K. (2020). *Raport vjetor.*
3. al., P. D. (200c). *Digital Era Governance.*
4. Bank, W. (201S). *Doing Business Report.*
5. Carter, F. B. (2008). *Trust and Risk in E-Government Adoption.*
- c. Dale, P. &. (1SSS). *Land Administration.*
7. Dijk, J. v. (2005). *The Deepening Divide.*
8. Dunleavy, P. M. (200c). *Digital Era Governance: IT Corporations, the State, and e-Government.* Oxford University Press.
- S. Enemark, S. (2005). *Understanding the Land Management Paradigm.*
10. Enemark, S. M. (2014). *Fit-for-Purpose Land Administration.*
11. FAO. (2017). *Responsible Governance of Tenure.*
12. Fountain, J. E. (2001). *Building the Virtual State: Information Technology and Institutional Change.*
13. Gwalani, A. M. (2020). Gwalani, Anil M. A. K. (2020). *E-Governance and Land Administration.*
14. Houghton, R. (2017). *Digital Transformation in Public Service.*
15. Jaeger, P. T. (2003). *The Endless Wire: E-Government as Global Phenomenon.*
- 1c. Kamari, F. (2017). *Kadastra si Instrument i Zhvillimit të Qëndrueshëm. Shqiperi.*

17. Larsson, G. (1SS1). *Land Registration and Cadastral Systems*.
18. Lee, K. L. (2001). *Developing Fully Functional E-Government*.
- 1S. McLaughlin, P. D. (1SSS). *Land Administration*.
20. McLaughlin, P. D. (1SSS). *Land Administration*.
21. Mergel, I. E. (201S). *Defining Digital Transformation in the Public Sector*.
22. Mergel, I., Edelmann, N., & Haug, N. (201S). *Defining Digital Transformation in the Public Sector*.
23. Norrström, A. (201S). *Smart Cities and Digital Governance*. Suedi.
24. OECD. (2020). *Digital Government Index*.
25. Pardo, J. R.-G. (2005). *E-Government Success Factors*.
- 2c. Rajabifard, A. W. (2012). *Spatially Enabled Government*.
27. Rees, J. T. (2021). *Modernizing Public Services*. Rees, John T. (2021). *Modernizing Public Services*.
28. Sharma, K. K. (2021). *Digital Land Administration*. Sharma, Kiran K. (2021). *Digital Land Management*.
- 2S. Simpson, S. R. (1S7c). *Land Law and Registration*.
30. StubkjFr, C. N. (2002). *A Review of Methodologies Used in Research on Cadastral Development*.
31. Tempini, A. C. (2015). *E-Government and Organizational Change*.

32. *Ting, L. & (1SSS). Cadastral Trends: A Synthesis.*
33. *UN-Habitat. (201c). Fit-for-Purpose Land Administration.*
34. *West, D. M. (2005). Digital Government: Technology and Public Sector Performance.*
35. *Williamson, I. E. (2010). Land Administration for Sustainable Development.*
- 3c. *Zevenbergen, J. (2002). Systems of Land Registration: Aspects and Effects. Delft, Netherlands. Delft University of Technology.*
- Zevenbergen, J. A. (2013). Pro-Poor Land Administration.*

SHTOJCAT

Pytësor

Autor: Shkurte Sadiku, studente e studimeve master

Ky pyetësor është anonim dhe realizohet për qëllime studimore. Të dhënat e mbledhura përmes këtij pyetësori do të përdoren vetëm për qëllime shkencore dhe janë konfidenciale.

* Indicates required question

1. **Gjinia? ***

Mark only one oval.

- ☐ M
- ☐ F

2. **Mosha? ***

Mark only one oval.

- ☐ 18-25
- ☐ 26-65
- ☐ 36-50
- ☐ 51+

3. **Niveli arsimor ***

Mark only one oval.

- ☐ Arsimi I ulet
- ☐ Shkolle e mesme
- ☐ Bachelor
- ☐ Master/PHD

4. **A mendoni se digjitalizimi ka reduktuar kohen e pritjes? ***

Mark only one oval.

- ☐ Shume
- ☐ Mesatarisht
- ☐ Pak
- ☐ Aspak

5. **Sa i kenaqur jeni me shërbimet digjitale? ***

Mark only one oval.

- ☐ Shume i kenaqur
- ☐ I kenaqur
- ☐ Pak i kenaqur
- ☐ Aspak i kenaqur

6. **Sa shpesh perdorni sherbimet online? ***

Mark only one oval.

- ☐ Gjithmone
- ☐ Shpesh
- ☐ Rralle
- ☐ Asnjehere

7. **A mendoni se informimi eshte me i shpejte dhe me i sigurt? ***

Mark only one oval.

- ☐ Plotesisht po
- ☐ Deri diku
- ☐ Po Pak
- ☐ Aspak

8. **Sa ka ndikuar teknologjia ne sherbimet kadastrale? ***

Mark only one oval.

- ☐ Shume
- ☐ Mesatarisht
- ☐ Pak
- ☐ Aspak

9. **A kane qytetaret rol aktiv? ***

Mark only one oval.

- ☐ Po shume
- ☐ Po deri diku
- ☐ Pak
- ☐ Aspak

10. **Sa e lehte eshte perdorimi i platformes? ***

Mark only one oval.

- ☐ Shume e lehte
- ☐ E lehte
- ☐ E veshtire
- ☐ Shume e veshtire

11. **A jeni te informuar per regjistrimin e pronave? ***

Mark only one oval.

- ☐ Shume i/e informuar
- ☐ Mesatarisht
- ☐ Pak
- ☐ Aspak

12. *

Mark only one oval.

- ☐ Plotesisht po
- ☐ Deri diku po
- ☐ Pak
- ☐ Aspak

13. Cilat jane sfidat kryesore? *

Mark only one oval.

- ☐ Mungesa e teknologjise
- ☐ Mungesa e trajnimit
- ☐ Probleme teknike
- ☐ Mungesa e besimit

14. A ka nevojë për trajnime stafi? *

Mark only one oval.

- ☐ Shume e nevojshme
- ☐ E nevojshme
- ☐ Pak
- ☐ Aspak

15. A mendoni se mungesa e digjitalizimit dhe dokumentacionit në sistemin kadastral ka ndikuar në problemet e komasacionit të tokave bujqësore në Komunën e Vitisë, duke vështirësuar blerjen dhe shitjen e tyre? *

This content is neither created nor endorsed by Google.

Google Forms